

• A K T I I T H E M E L I M I



**I SHOQERISE NDERTUESE PRIVATE
"MENI" SH.P.K.**

Ne baze te ligjit nr.7512 date 08.10.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" si dhe ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", me vullnetin e tij te lire z.Niat Lici, i biri i Muhametit, i datelindjes 1966, banuese ne Cirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar shpall si vijon :

NENI 1

Formohet shoqeria ndertuese private "MENI" sh.p.k. me themelues z.Niat Lici.

NENI 2

Kjo eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te themeluesit ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne Rrugen Qendral Stafa Nr.12. Ajo mund te hape dhe seli te tjera te dyta, dege filiale, perfaqesi si dhe agjenci operative ne te gjitha teritorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj ekonomike ne nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

NENI 5

Objekti i veprimtarise do te jete : •ndertime, prodhime materialesh, transportuese materialesh ndertimi, tregtim materialesh ndertimi dhe ushqimore me shumice dhe pakice.

NENI 6

•Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000 leke i pebere nga kontributi i ortakut te vetem themelues. Kapitali themelues mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marri ky ortak. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem e i nenshrueshem.

Handwritten signature

NENI 7

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "MENI" sh.p.k., Korce..

NENI 9

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- administratorja
- komisioni i revizionimit

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese do te rregullohet me statut.

NENI 10

Administrator i shoqerise "MENI" sh.p.k. eshte z. Niat Lici.

NENI 11

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij akti themelimi e te statutit i cili formulohet e nenshkruhet nga administratorja, si dhe ne perputhje me ligjeslacionin shqipetar ne fuqi.

NENI 13

Statuti i shoqerise "MENI" sh.p.k. eshte pjese perberese e ketij akti themelimi.

NENI 14

Ky akt themelimi perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

O R T A K U

NIAT LICI

N. Lici

N. Lici



S T A T U T

I SHOQËRIË NDERTUESE PRIVATE SH.P.K

Ne baze të ligjit nr.7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire te veprimtarise private te Davaur dhe privatizimit", si dhe ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me vullnetin e saj te lire, te shprehur ne nenshkrimin e ketij statuti dhe ne aktin e themelimit, z.Niat Lici, i biri i Muhametit, i datelindjes 1966, banuese ne Korce., me zotesi te plote juridike per te vepruar shpall si vijon:

FORMIMI I SHOQËRIË NDERTUESE PRIVATE

M.L.



NENI 1

Formohet shoqeria tregtare private e emertuar "MENI" sh.p.k. me themeluese z.Niat Lici..

FORMA

NENI 2

Shoqeria tregtare private "Meni" sh.p.k. eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

SELIA E SHOQERISE

NENI 3

Shoqeria tregtare private "MENI" sh.p.k. e ka seline e saj ne Rrugen *Qemal Stafa Nr 12*, Korce. Ajo mund te hapi seli te tjera te dyta, dege filijale, perfaqesi si dhe agjenci operative ne te gjithë territorin e Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 4

Shoqeria tregtare private "MENI" sh.p.k. do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj ekonomike ne nje afat te pa caktuar mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe per cfaredo shkak.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 5

Objekti i veprimtarise se saj do te jete: ndertime, tregtime materiale, transportuese dhe ushqimore me shumice dhe pakice..

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000 leke i perbere nga kontributi i ortakut te vetem themelues. Kapitali themelues mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marri ky ortak. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

NENI 7

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros dhe te tjera te nevojshme te luejteshme apo te paluejteshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 8

Aktiviteti dhe fitimet qe do te realizohen gjate veprimtarise konkretizohen ne nxjerrjen e bilanceve periodike e vjetore.

U.L.C.

NENI 9

Shoqeria tregtare private "MENI" sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe mund te shfrytetoje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten e shitjes se pasurise se vet tek te tretet. Ne Republiken e Shqiperise kjo shoqeri gezon te drejta si c'do person tjetër juridik shqiptar ose i huaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 10

Shoqeria tregtare private "MENI" sh.p.k. vepron ne regjistrin e prones dhe merr persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda kapitalit te saj. Ortaku i vetem themelues mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

NENI 11

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- Administratorja
- Komisioni i revizionimit

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese do te rregullohen si me poshte:

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 12

Administratori i shoqerise tregtare private "MENI" sh.p.k. eshte ortakja e vetme e saj z.Niat Lici.

NENI 13

Shoqeria tregtare private "MENI" sh.p.k. deklarohet e krijuar me zbatimin e plote te normave qe permban ky statut dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi. Ajo fiton zotesine e saj per te vepruar me rregjistrimin e saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane dhe ushtron veprimtarine ekonomike me rregjistrimin ne organin perkates tatimor.

NENI 14

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "MENI" sh.p.k., Korce.


NENI 15

Administratori sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise ekonomike e financiare puneson persona te ndryshem.

NENI 16


Administratori dhe personi i ngarkuar prej tij jane te veshur me te gjithë fuqine per detyrimin e zakonshem e te jashtezakonshem

W. L.



te shoqerise pa asnje kufizim. Ata kane mundesine per te kryer te gjithë aktet qe konsiderojne te pershtatshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Ata kane te drejte, midis te tjerave, te blejne e te kembejne pasurite qe lidhen me shoqeri te tjera te krijuara brenda dhe jashte vendit duke siguruar pjesmarjen per rrezikimet e veprimtarise te parashikuara nga neni 5 i ketij statuti. Ata kryejne cdo lloj veprimi prane te gjithë zyrave shteterore e private qe kane te bejne me veprime ipotekore, te kryejne prane institucioneve bankare e financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa dhe arketimi si dhe veprime te tjera qe i sherbejne aktivitetit. Ne keto raste personi i ngarkuar nga administratorja eshte i detyruar te njoftoje e t'i jape llogari atij.

NENI 17



Administratori ishogerise emerohet punonjës i tjerë te cileve u cakton detyrat dhe pagen, po keshtu vepron dhe me personat e tjere te punesuar. Shoqeria merr persiper te respektojte rregullat e punesimit ne R.SH. dhe sig. shoqerore, ndersa te gjithë te punesuarit jane te detyruar te pranojne statutin e shoqerise.

MARDHENIET E PUNES

NENI 18

Mardheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kete kontrate zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi. Mosmarveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise se saj, nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 19

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise do te mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore bilanci kontabel mbyllet sipas ligjeve ne fuqi. Bilanci kontabel miratohet dhe nenshkruhet nga administratorja. Me miratimin e saj administratorja vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme si ate te akumulimit, rezerve, etj.

NENI 20

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve te permendura me siper dhe shlyerjes se detyrimit fiskal i mbesin ne perdorim ortakut te vetem te shoqerise. Konvertimi i parase se realizuar nga veprimtaria do te behet sipas kushteve qe do te kete banka kometare ose bankat e tjera dhe transferimi i saj do te behet sipas ligjeve shqiptare.

Chil

SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 21

Shperberja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per shkakto nga shkaqet : humbje e kapitalit, pamundesi te primit ne kete rast ortakut i vetem vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje menyre me shume likujdatore duke ju percaktuar detyra.

Likujdatoret jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise per derisa t'ju dorezohen personave perkates fizik e juridik duke likuiduar ne radhe te pare personat e trete te shoqerise. Nese fondet qe disponohen jane te pamjaftueshme per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likujdatoret mund ti kerkojne ortakut te derdhi teresisht kuoten e nevojshme.

DIPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 22

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje administratorja si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqipetar. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti.

NENI 23

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'ju shpendare organeve kopetente si dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te kesaj shoqerie. Statuti miratohet nga ortakja e vetme dhe nenshkruhet nga ajo rregullisht.

O R T A K U

NIAT LICI.

N. Lici
et cetera